



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.164/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Zyndi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit “VAKAT”, dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, Anr.164/2019 e datës 01.10.2019, ndërsa koalicionit “VAKAT”, dega në Prizren, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 1100.00 € (një mijë e njëqind euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datë 01.10.2019, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 30.09.2019, në rrugën e fshatit Gornjaselë, në Komunën e Prizrenit, nga ana e monitoruesve të tyre është parë një poster i njërit nga kandidatët për deputet nga radhët e koalicionit “VAKAT”, ngjitur në hapësirë publike, respektivisht në shtyllë elektrike, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim me nenin 33 par.1, pika b) të LZP-së.

Ankuesi si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të posterit të kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit “VAKAT”, të ngjitur në shtyllë elektrike.

Në përgjigje në ankesë, të datës 02.10.2019, koalicioni “VAKAT”, ka theksuar se vendosja e posterit në fjalë është bërë prej njërit nga simpatizuesit e tyre, megjithëse nga ana e këtij subjekti politik janë bërë njoftimet e nevojshme që anëtarët dhe mbështetësit e tyre të respektojnë rregullat zgjedhore, mirëpo personi që ka vendosur posterin nuk ka qenë në dijeni se ky veprim përbën shkelje sipas dispozitave ligjore të LZP-së. Më tej ka shtuar se nga ana e tyre janë ndërmarrë veprime në drejtim të përmirësimit të shkeljes, ashtu që është bërë largimi i posterit në fjalë, për çka edhe kanë bashkangjitur disa fotografi të printuara, në cilësi të provave materiale. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që në matjen e dënimit të marrë parasysh veprimet për përmirësimin e shkeljes dhe faktin se koalicioni “VAKAT”, është një nga subjektet politike më të disiplinuara në respektimin e rregullave zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit "VAKAT", është ngjitur në hapësirë publike, respektivisht në shtyllë elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së, e cila dispozitë përcakton: "*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*".

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit "VAKAT", është shkelur dispozita e lartëcekur ligjore, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga radhët e këtij koalicioni, është vendosur në objektin publik përkatësisht në shtyllë elektrike e cila konsiderohet pronë publike dhe nuk është hapësirë e dedikuar për vendosje të posterëve.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit të koalicionit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se koalicioni "VAKAT", ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjtë është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, i'a dha mundësinë për tu përgjigjur në ankesë, dhe i njëjti ka deklaruar se janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografitë e bashkangjitura në përgjigje. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullores së PZAP-it Nr. 01/2012, shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund te shqiptohet gjobë subjektit politik nga 5,100.00euro, deri në 20,000.00 euro, për subjektet politike që kanë qenë te përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e koalicionit "VAKAT", për ta përmirësuar shkeljen, kaNë ndikuar në uljen e lartësisë e gjobës.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr. 164/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.
